



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0755

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) BUSINESS PRO SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Gjakova SH.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Plomba dhe Bllokues të valvulave me numër të prokurimit KRURGJA-25-5450-1-2-1, me 07.10.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE BUSINESS PRO SH.P.K., me nr. 2025/0755, e datës 08.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Plomba dhe Bllokues të valvulave me numër të prokurimit KRURGJA-25-5450-1-2-1.
2. Anullohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Gjakova SH.A., ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim me Plomba dhe Bllokues të valvulave me numër të prokurimit KRURGJA-25-5450-1-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik BUSINESS PRO SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.06.2025 Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova SH.A., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizim me Plomba dhe Bllokues të valvulave, me numër të prokurimit KRURGJA-25-5450-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 28,000.00 Euro.

Me 30.07.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Me 04.08.2025, OE BUSINESS PRO SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, ku AK nuk ka kthyer përgjigje.

Me 08.08.2025, OE BUSINESS PRO SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0755, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik BUSINESS PRO SH.P.K., lidhur me ankesën 0755/2025:

Mbetemi prapa të gjitha pretendimeve tona të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim, duke theksuar se Autoriteti Kontraktues e ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurim Publik. Për më tepër, pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, AK nuk është përgjigjur ndaj saj dhe as nuk ka ofruar ndonjë arsyetim apo kërkesë për shtyrje të afatit ligjor për kthimin e përgjigjes.

Me këtë veprim, sipas mendimit tonë, përveç shkeljeve të bëra me anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, AK ka vazhduar me shkelje të mëtejshme të këtyre dispozitave, duke kryer një shkelje të rëndë të nenit 108/A, paragrafi 6 të LPP-së. Ashtu siç edhe theksuam më lart, pretendimet tona janë të njëjta me ato në kërkesën për rishqyrtim, prandaj vetëm sa po i përshkruajmë në këtë ankesë.

Në përputhje me nenin 109, në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me nr. të prokurimit KRURGJA-25-5450-1-2-1, me titull "Furnizim me Plomba dhe Bllokues të Valvulave", paraqesim këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit, për arsyet si në vijim:

Pretendimi nr. 1 – Anulimi pas hapjes së ofertave për arsye buxhetore është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Shkelja e nenit 43 të Rregullores për Prokurim Publik.

Sipas nenit 43.5 të Rregullores për Prokurim Publik, nuk ekziston asnjë dispozitë që lejon anulimin e procedurës për shkak të mungesës së mjeteve financiare apo stoqeve të papritura. Arsyet e lejueshme për anulim janë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe përfundimtare (taksative) në këtë nen, dhe vendimi i marrë nga AK bie ndesh me këtë rregullativë.

Shkelja e nenit 9 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Sipas këtij neni, autoriteti kontraktues ka për detyrë të bëjë një vlerësim formal të nevojave dhe të sigurohet që ka fonde të ndara për përmbushjen e kontratës para nisjes së aktivitetit të prokurimit. Publikimi i dosjes së tenderit nënkupton se këto procedura janë kryer dhe janë të dokumentuara. Prandaj, justifikimi i mëvonshëm për anulim për shkak të "shpenzimeve të paparashikuara" apo "sasisë në stok" është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesat e Ligjit.

Dëmtimi i konkurrencës dhe shpenzim i panevojshëm i burimeve.

Vendimi për anulim pas hapjes së ofertave, pa ndonjë bazë të ligjshme, dëmton integritetin e procesit të prokurimit, bie ndesh me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe krijon pasiguri për operatorët ekonomikë që kanë investuar kohë, burime teknike dhe financiare për përgatitjen e ofertave.

Pretendimi nr. 2 – Qasja në dokumentacion.

Në të njëjtën kohë, dëshirojmë të theksojmë shkeljen flagrante të të drejtës sonë për qasje në dokumentacion, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së. Pavarësisht kërkesës sonë zyrtare të bërë me datë 31.07.2025 (përmes e-prokurimit dhe përmes emailit të dërguar), Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje/arsyetim dhe nuk na ka lejuar qasjen në dokumentacionin përkatës, ndonëse kjo është një e drejtë e garantuar me ligj.

Moslejimi i qasjes në dokumentacion na shtyn të dyshojmë se ka pasur një komision vlerësues i cili e ka përfunduar vlerësimin dhe ka marrë një vendim, por që ky vendim nuk është aprovuar nga ZKF – Zyrtari Kryesor i Financave dhe ZKA – Zyrtari Kryesor Administrativ, ndoshta për shkak se vendimi i komisionit nuk ka qenë në përputhje me preferencat e tyre. Si pasojë, është sajuar një arsyetim formal për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndonëse pa asnjë bazë ligjore. Sipas bindjes sonë, kjo është arsyeja e vërtetë pse nuk na është mundësuar qasja në dokumentacion.

Përfundim

Bazuar në sa më sipër, vlerësojmë se:

AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim të qartë me nenin 9 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurim Publik;

AK ka shkelur rëndë nenin 108/A, paragrafi 6 të LPP-së, duke mos u përgjigjur në kohë në kërkesën tonë për rishqyrtim dhe pa asnjë njoftim për shtyrje të afatit;

AK ka cenuar të drejtën tonë ligjore për qasje në dokumentacion, në kundërshtim me nenet 10 dhe 11 të LPP-së.

Kërkesë për OSHP

Në përputhje me kompetencat e Juaja, i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) që:

Të konstatojë se vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është i kundërligjshëm dhe i paarsyetuar;

Të konstatojë shkeljet ligjore të nenit 9 të LPP-së dhe nenit 43 të Rregullores;

Të konstatojë shkeljen e afatit ligjor (neni 108/A) dhe të drejtës për qasje në dokumentacion nga ana e AK (neni 10 dhe 11 i LPP-së); dhe

Të urdhërojë kthimin e lëndës për rivlerësim dhe vazhdim të procedurës në përputhje me ligjin.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: AK nuk ka nxjerr Vendim për kërkesën për rishqyrtim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12.08.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0755, ndërsa me datë 15.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0755. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues po ashtu as OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE BUSINESS PRO SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0755, ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Kompania Rajonale e Ujësjetësimit GJAKOVA SH.A, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës është 28,000.00 €. Ndërsa, kriteri i dhënies së kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarohet se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,9, 10 dhe 11 të LPP-së, si dhe nenin 43.5 të Rregullores për prokurim Publik. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon se AK nuk është përgjigjur ndaj kërkesës për rishqyrtim fare si dhe anulimi i aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave për arsye buxhetore është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi përkatësisht me nenin 43.5 të Rregullores për prokurim publik. Tutje, OE potencon se vendimi për anulim pas hapjes së ofertave pa ndonjë bazë ligjore dëmton integritetin e procesit të prokurimit dhe bie ndesh me transparencën dhe trajtimin.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimi i OE ankuese është i bazuar, pasi AK nuk ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga OE, duke vepruar në kundërshtim me obligimin ligjor të përcaktuar në nenin 108/A të LPP-së.

Sa i përket pretendimit se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit pas hapjes së ofertave për arsye buxhetore, ekspertja shqyrtuese sqaron se, sipas Njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 30.07.2025, AK ka vepruar në bazë të rekomandimit të ZKF-së të datës 22.07.2025 dhe Vendimit të ZKA-së të datës 23.07.2025, ku është theksuar: "...të anulohet kjo procedurë për shkak të disa shpenzimeve të paparapara të kompanisë, bazuar edhe në disa stoqe të bllokueseve dhe bllombave, dhe të shtyhet për vitin tjetër." Ky arsyetim nuk gjen mbështetje në nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022, pasi në këtë fazë të procedurës pas hapjes së ofertave dhe ngarkimit të Deklaratës së Nevojave dhe përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, në të cilën në piken II.1.3 është shënuar vlera e parashikuar, anulimi për arsye të tilla nuk është i bazuar dhe i ligjshëm. Prandaj, AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022. Pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues potencon se ka bere kërkesë për qasje në dokumentacion në përputhje me nenin 10 dhe 11 të LPP-së. AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje të arsyetuar dhe nuk ka lejuar qasje në dokumentacionin përkatës. Moslejimi i qasjes në dokumentacion e shtyn të dyshojë se ka pasur një komision vlerësues i cili ka përfunduar vlerësimin dhe ka marrë një vendim, por që ky vendim nuk është aprovuar nga ZKF – Zyrtari Kryesor i Financave dhe ZKA – Zyrtari Kryesor Administrativ, ndoshta për shkak se vendimi i komisionit nuk ka qenë në përputhje me preferencat e tyre. Si pasojë, është sajuar një arsye formale për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndonëse pa asnjë bazë ligjore. Sipas bindjes së OE ankues, kjo është arsyeja e vërtetë pse nuk është mundur qasja në dokumentacion.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Sa i përket pretendimit të OE ankues, ekspertja shqyrtuese sqaron se, ashtu siç theksohet në ankesë, "mungesa e qasjes në dokumentacion dhe mos përgjigja e AK-së ndaj kërkesës për qasje" përbën shkelje të dispozitave të nenit 10 dhe 11 të LPP-së, mosdhënia e qasjes cenon të drejtën e operatorit ekonomik për transparencë, por krijojnë edhe dyshime të arsyeshme mbi procedurën e ndjekur nga autoriteti kontraktues kjo bie ndesh me parimet themelore të barazisë në trajtim dhe transparencës, të garantuara nga LPP, ekspertja shqyrtuese vlerëson, se përderisa OE ankues nuk është lejuar të ketë qasje në dokumentacion, i është pamunduruar të paraqesë pretendime të bazuara në prova konkrete

materiale. Andaj rekomandoj panelin shqyrtues që gjatë rivlerësimit ta obligon Autoritetin Kontraktues që të ofron qasje operatorëve ekonomik të interesuar konform dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik përkatësisht nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Vlen të theksohet se në lidhje me kërkesën për rishqyrtim dhe emalin e datës 23.07.2025, me datë 13.08.2025, përmes e-mailit zyrtar i jemi drejtuar autoritetit kontraktues me kërkesë për sqarime, dhe të njëjtit kanë kthyer përgjigje.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A, të anuloi njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës: 30.07.2025, dhe të beje vlerësimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Plomba dhe Bllokues të valvulave me numër të prokurimit KRURGJA-25-5450-1-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Kompania Rajonale e Ujësjetës GJAKOVA SH.A.**
- **OE - BUSINESS PRO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: